

Angazhohu Monitoro Veopro



Suplement nga Grupi Monitorues i Këshillit Bashkiak, Pogradec Janar 2012

Nëse vetëm unë flas për padrejtësinë,
Ajo mbetet veç një pëshpërimë,
Nëse flasim dy vetë, bëhet një bisedë,
Nëse flasim të gjithë bashkë, do të jemi një zë që dëgjohet!



Në foto: Grupi i Monitorimit gjatë trajnimit për Vullnetarizmin

Këshilli bashkiak dhe
mbledhjet e tij

Demokracia lokale dhe
monitorimi

Roli i Këshilltarit Vendor

Lexoni në faqen 8, 9, 10, 11

Njoftim për mbledhjen e Këshillit të Bashkisë Pogradec

Njoftohen qytetarët se ditën e martë, në datën 07.02.2012, ora 10:00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit, do të zhvillohet mbledhja me këtë rend dite:

1. Projekt-vendim "Mbi miratimin e ndihmës ekonomike për muajin dhjetor 2012".
2. Projekt-vendim "Për miratimin e ndihmës ekonomike për muajin janar 2012".
3. Projekt-vendim "Mbi miratimin e listave emërore të qytetarëve të pastrehë që kanë aplikuar për kredi dhe largimin nga lista e të pastrehëve të familjeve që kanë përfituar kredi me kushte lehtësuese".
4. Projekt-vendim "Mbi rishqyrtimin e Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr 52, datë 09.12.2011, "Mbi buxhetin e Bashkisë Pogradec për vitin 2012".
5. Projek-vendim "Për binjakëzim të qytetit të Pogradecit me qytetin Ovidiu të Rumanisë".
6. Projekt-vendim "Mbi rishqyrtimin e vendimeve nr 44,45,46 të Këshillit të Bashkisë nr 47, datë 25.11.2011".
7. Projekt-vendim "Mbi rishqyrtimin e vendimit të Këshillit të Bashkisë nr 47, datë 25.11.2011".
8. Të ndryshme (shkresa dhe kërkesa të mbërritura).

Komisionet e përhershme të Këshillit do të mblidhen ditën e hënë, datë 06/02/2012, si më poshtë:

- Komisioni Ekonomik i Financës, orë 10:00, për pikën 4 të rendit.
- Komisioni i ligjshmërisë dhe Çështjeve Sociale, ora 11:00, për pikat 3 dhe pikat 5-7.

**Grupi Monitorues
Shoqata "Unë, Gruaja" Pogradec**

“Gjithçka në një vend demokratik fillon me lejen nga publiku dhe ekziston nga miratimi publik

Këshilli bashkiak dhe mbledhjet e tij

Këshilli Bashkiak është organi përfaqësues i bashkisë.

Ai përbëhet nga këshilltarë të zgjedhur sipas dispozitave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Numri i anëtarëve të këshillit komunal dhe bashkiak përcaktohet sipas numrit të popullsisë

Prefekti përcakton numrin e anëtarëve të këshillit për çdo bashki nën juridiksionin e tij, mbi bazën e numrit të banorëve sipas evidencave të zyrave të gjendjes civile të datës 1 janar të vitit kur zhvillohen zgjedhjet.

Këshilli i Bashkisë organizon dhe realizon veprimtarinë e tij në bazë të Kushtetutës, Ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore” dhe në përputhje me rregulloren përkatëse të tij.

Këshilli bashkiak ushtron funksionet e tij qysh nga krijimi, deri në krijimin e këshillit të ri pasardhës.

Ai i zhvillon mbledhjen e tij të parë jo më vonë se 20 ditë nga shpallja e rezultatit të zgjedhjeve nga K.Q.Z. Në këtë mbledhje zgjidhet kryetari dhe zëvendës kryetari me votim të fshehtë.

Këshilli bashkiak ka një kryesi e cila përbëhet nga: kryetari i këshillit, zëvendës kryetari, sekretari, kryetarët e grupeve të këshilltarëve dhe kryetari i bashkisë ose zëvendëskryetari (ose një person i autorizuar prej tij).

Këshilli Bashkiak ka organet e veta që janë komisionet. Që mund të jenë të përhershme ose të përkohshme.

Mbledhjet e këshillit bashkiak zhvillohen si rregull, sipas përcaktimit që bën vetë këshilli, por jo më pak se një herë në muaj.

Këshilli mund të mblidhet jashtë radhe:

a) me kërkesën e kryetarit të komunës ose bashkisë;

b) me kërkesën e 1/3 së anëtarëve të tij;

c) me kërkesën e motivuar të prefektit për çështje që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tij.

Thirrja për mbledhjen e këshillit bëhet nga kryetari i këshillit dhe njoftimi për mbledhjen bëhet, jo më pak se 5 ditë para datës së zhvillimit të saj.



Në periudhën nga data e zgjedhjeve e deri në konstituimin e këshillit të ri, këshilli i mëparshëm komunal ose bashkiak ushtron funksione të kufizuara dhe merr vendime vetëm në raste të situatave emergjente.

Mbledhja e këshillit komunal ose bashkiak quhet e vlefshme kur në të merr pjesë shumica e të gjithë anëtarëve të këshillit, me përjashtim të rasteve kur kërkohet një shumicë tjetër për marrjen e vendimeve.

Kur këshilli nuk mblidhet për shkak të mungesës së anëtarëve të tij gjatë tre muajve, duke filluar nga data e mbledhjes së fundit të tij, këshilli quhet i vetëshpërndarë. Vetëshpërndarja pasohet me zgjedhje të reja për këshillin përkatës dhe sekretari i këshillit komunal ose bashkiak, brenda 10 ditëve nga përfundimi i afatit 3-mujor, njofton prefektin.

Mbledhjet e këshillit fiksohen në procesverbalin e mbledhjes.

Votimi në këshill bëhet i hapur ose i fshehtë. Këshilli vendos për rastet kur votimi bëhet i fshehtë. Aktet me karakter individual miratohen kurdoherë me votim të fshehtë.

Vendimet e këshillit ndahen në :
-vendime që merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

-vendime që merren me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit

-vendime që merren me tre të pestat të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit

Aktet e këshillit shpallen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të tyre subjekteve që përfshihen në to.

Mbledhjet e këshillit janë të hapura për publikun. Çdo qytetar lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit.

Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara nga këshilli dhe në media. Njoftimi përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.

Këshilli, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, vendos për rastet kur mbledhja bëhet e mbyllur.

Këshilli bashkiak, përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve,

zhvillon seanca këshillimi me bashkësinë.

Këshillimi me bashkësinë, në çdo rast, bëhet sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit, duke përdorur një nga format e nevojshme si takimet e hapura me banorët, takime me specialistë, me institucione të interesuara dhe organizata joqeveritare ose nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore.

Aktet e këshillit afishohen në vende publike të caktuara nga këshilli, brenda territorit të komunës ose bashkisë dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre.

Te gjitha shkresat, letrat apo ankesat e komunitetit që vijnë në adresë të këshillit Bashkiak, regjistrohen në zyrën e protokollit të bashkisë dhe mbasi i bëhen të njohura kryetarit të këshillit bashkiak, rikthehen në zyrën e protokollit për vazhdimin e procedurës me to.

Administrata e bashkisë shqyrton problemet e ngritura në to dhe del me propozime konkrete për zgjidhjen e tyre.

Në mbledhjen më të afërme të këshillit, sekretari i këshillit i bën të njohur këshillit bashkiak duke informuar për letrat, ankesat, shkresat e ardhura në adresë të këshillit dhe sipas rastit paraqet propozimet e zyrave të administratës së bashkisë.

Kleda Shyta



Demokracia lokale dhe monitorimi

Shkruar nga **Ilir Buzali**

Ç' do të thotë të jesh i monitoruar?

Kohë më parë mediat publikuan një lajm interesant: kryebashkiaku i një kryeqyteti latino-amerikan, kishte vendosur në zyrën e tij një kamera vëzhguese dhe qytetarët mund të verifikonin në çdo orë të ditës se ç' bëhej në atë zyrë. Ishte një zgjidhje e zgjuar: kështu aktiviteti i kryebashkiakut bëhej në transparencë të plotë dhe nga ana tjetër i mbyllej rruga çdo abuzimi të mundshëm apo akuze të pabazuar ndaj tij, në zyrën publike. Vlerësimi i personalitetit dhe korrektësisë së tij bëhej drejtpërdrejt dhe nga çdo qytetar i thjeshtë.

Ndoshta s' është komode të jesh i monitoruar, por kur bëhet fjala për një aktivitet publik, ky është një proces i domosdoshëm dhe jetik për demokracinë lokale. U bënë disa vite që këshilli bashkiak i Pogradecit monitorohet nga shoqata "Unë, Gruaja". Duke bërë transparencën e aktivitetit të këtij këshilli, aktivistët e shoqatës kanë krijuar një përvojë të pasur.

Monitorimi konsiston në punën përgatitore të mbledhjes së këshillit dhe procedurën e zhvillimit të saj. Gjithçka fillon me një studim të përbërjes së këshillit, profilin e secilit, raporteve gjinore e moshore, niveli profesional etj. Ky është objekti i monitorimit, i cili do të ndiqet më tej në aktivitetin publik, sipas fazave.

E gjithë platforma e monitorimit është mbështetur mbi ligjin për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore. Pjesa e parë e monitorimit ka të bëjë me punën përgatitore të personave përgjegjës, në mënyrë që mbledhjet të bëhen vërtet të hapura dhe transparente, ashtu siç e kërkon ligji. Kështu për fazën e punës përgatitore monitorohet afati dhe mënyrat e njoftimit të mbledhjes së këshillit, afati i shpërndarjes së materialeve tek këshilltarët, përcaktimi i axhendës së mbledhjes dhe respektimi i saj.

Mbi bazën e një udhëzuesi të thjeshtë, monitoruesit vlerësojnë njoftimin publik për mbledhjet, konform kërkesave të ligjit përkatës, pjesëmarrjen e këshilltarëve në mbledhje, diskutimet dhe debatet, votimet dhe vendimet

e marra. Të gjitha këto të shoqëruara me filmime dhe fotografime.

Produkti i këtij monitorimi publikohet në media me një synim të dyfishtë:

1. të njihen qytetarët me vendimmarrjen lokale

2. të njihen këshilltarët me performancën e tyre dhe njëkohësisht të bëhen më të përgjegjshëm, duke u ndier të monitoruar.

Kur bie fjala për bashkinë, qytetarët në masë, si simbol dhe përfaqësues të këtij organi njohin kryetarin e bashkisë. Vetë këshilltarët ndjehen shpesh në hije dhe e trajtojnë kontributin e tyre thjesht si një votë pro ose kundër. Monitorimi i nxjerr ata nga anonimati dhe u jep vendin që duhet të kenë dhe kanë sipas ligjit. Publikimi i debateve në mbledhje, raporteve të monitorimit, nxjerr në dukje dhe diferencon individualitetin dhe kontributin e secilit. Veçanërisht del në dritë roli i këshillit në tërësi: vërtet ekzekutivi mund të konceptojë e të përgatisë projektvendime, por ato nuk mund të miratohen e të zbatohen pa kaluar në filtrin e këshillit dhe pa marrë votën e tij.

Monitorimi për disa vite me radhë prej shoqatës "Unë, Gruaja" i këshillit bashkiak të Pogradecit ka dhënë frytet e veta duke ndikuar në cilësinë e aktivitetit të tij. Kam parasysh këtu situatën fillestare të disa viteve më parë, kur seancat ktheheshin në "muhabete", ku herë pas here këshilltarët dilnin në ballkonin e sallës së mbledhjes për të pirë duhan dhe njëkohësisht ndërhyenin në debate... Një situatë që tani as përfytyrohet. Të ndodhesh para "kamas vëzhguese" të një grupi monitorues, do të thotë të ndjehesh ballë për ballë qytetarëve, atyre që të kanë dhënë votën e që i takon përditë.

Po cilët kanë qenë dhe janë përfituesit e këtij aktiviteti? Së pari përfiton qeverisja vendore në të dy sektorët, vendimmarrës dhe ekzekutiv. Përderisa bëhen më të përgjegjshëm këshilltarët, edhe cilësia e vendimmarrjes është më e lartë. Së dyti përfitojnë qytetarët. Infrastruktura nuk e bën të mundur pjesëmarrjen masive në mbledhjet e hapura të këshillit. Pjesëmarrja e 5 apo 10 qytetarëve nuk e bën të mundur transparencën e punës së këshillit. Zgjidhja më e mirë është monitorimi dhe ndjekja e aktivitetit të këshillit nga persona të trajnuar dhe të specializuar, që raportojnë në mënyrë periodike. Publikimi i raporteve i

bën ato pronë të gjithë qytetarëve të interesuar, pa dallim.

Por palë përfituese është edhe ekipi monitorues që pasuron eksperiencën nga viti në vit, duke bërë të mundur që të rritet cilësia e monitorimit. Kështu është krijuar një spirale në rritje e një aktiviteti ku përfshihen palë të ndryshme. Projekti aktual i shoqatës "Unë, Gruaja", i titulluar "Ndërgjegjësohu - Monitoro - Vepro!" mbështetet pikërisht në këtë spirale, duke përcaktuar tre hapa, për të mos mbetur thjesht tek faza e monitorimit, pra e konstatimit. Paralelisht me këtë monitorim realizohet edhe një anketim i gjerë i qytetarëve mbi perceptimin e tyre për performancën e këshillit bashkiak.

Dy këndvështrime të ndryshme për një rezultat të përbashkët: një demokraci lokale të prekshme dhe reale.

Emrat e Këshilltarëve të Këshillit Bashkiak Pogradec sipas subjekteve politike

1. Sotiraq Mangëri PS
2. Ferdinand Katiraj PS
3. Nexhmie Dervishi PS
4. Syrja Palla PS
5. Luan Maxhari PS
6. Natalja Velo PS
7. Stefan Hila PS
8. Guri Ademaj PS
9. Hasan Laho PD
10. Alketa Jajçari PD
11. Leonard Berberi PD
12. Sandri Kyçyku PD
13. Luan Tollozhina LSI
14. Vangjo F.Gusho LSI
15. Matilda Hoxha LSI
16. Eduard Kapri PSD
17. Jeta Rapçe PSD
18. Avdulla Cano PR
19. Evelina Riska PR
20. Petro Stefani PDS
21. Thoma Angjellari PSV 91
22. Arian Mema PDK
23. Ilir Gusho LDK
24. Valter Hamollari PDIU
25. Mimoza Shuli ADL

Roli i Këshilltarit Vendor

Roli dhe angazhimi i këshilltarit ndryshon në varësi të madhësisë dhe funksionit të autoritetit, nëse partia juaj e drejton këshillin apo është duke punuar në opozitë, dhe gjithashtu, nga përgjegjësia që ka vendosur të marrë ky individ. Prapë se prapë, gjithmonë ka tre role të veçantë që kryen nga të gjithë këshilltarët:

Ø Këshilltarët formulojnë politikën, duke caktuar burimet dhe vëzhguar shërbimet.

Ø Shpenzojnë kohë duke ndërtuar lidhje me qytetarët, për të ruajtur kontaktet me çështjet vendore dhe për të marrë masat përkatëse.

Ø Gjithashtu, këshilltarët janë zëdhënës të partisë dhe pritet që t'u binden rregullave të saj, si dhe të ngrenë vlerat e saj.

Koha e shpenzuar për secilin nga këta role ndryshon meqë me kalimin e kohës ngrihen çështje të ndryshme dhe zhvillohet interesimi dhe kompetenca për atë.

Roli në Këshill

Zgjedhësit u japin këshilltarëve të tyre përgjegjësinë për të siguruar se komuniteti do të marrë shërbime cilësore dhe vlera për para. Këshilltarët e bëjnë këtë duke parashtruar politikën dhe prioritetet e Këshillit në mbledhjet e këtij këshilli. Më pas, është detyrë e Nëpunësve të Këshillit që të zbatojnë këto vendime dhe të sigurojnë se këto shërbime po shpërndahen.

Komisionet e Këshillit

Volumi i punës së Këshillit kërkon shpërndarje/ delegim të përgjegjësive në komisione. Komisionet mbikqyrin shërbimet e Këshillit. Ato përbëjnë vendin ku zhvillohen diskutimet e hollësishme dhe këshilltarët duhet të marrin pjesë të paktën në një ose dy komisione. Struktura e komisionit ofron një forum ku këshilltarët mund të debatojnë programet e tyre politike.

Vendime shumë të rëndësishme merren në komisione dhe një votë

në komision vendos nëse një projekt i veçantë duhet të ecë më tej ose jo. Gjatë punës së tyre në komisione, shpesh, këshilltarët vënë në përdorim aftësi të fituara nga përvoja e tyre në veprimtaritë në terren. Sapo një këshilltar ka fituar një kompetencë në një komision, ai mund të dëshirojë të bëhet kryetar. Të jesh kryetar komisioni është një mënyrë tjetër për të marrë mbi vete role shtesë dhe për t'u bërë një figurë e lartë.

Këshilli i Plotë¹

Mbledhjet e gjithë këshillit janë të rëndësishme. Ky është vendi ku merren të gjitha vendimet më domethënëse si buxhet vjetor etj. Këto mbledhje marrin nga një raport nga secili komision, ku përshkruhet puna e bërë prej tyre dhe se çfarë rekomandimesh dëshirojnë ata që këshilli të prapashkruajë/ miratojë. Gjithashtu, këto mbledhje ofrojnë mundësinë për të bërë pyetje - si me shkrim ashtu dhe me gojë - për kryetarët e komisioneve rreth çdo çështjeje brenda fushës së tyre. Gjithashtu, mbledhjet e plota të këshillit përbëjnë dhe një mundësi politike për këshilltarët. N.q.s. partia juaj kontrollon këshillin, atëherë këshilltarët mund të përdorin kohën e pyetjeve për të tërhequr vëmendjen mbi sukseset e tyre vendore ose mbi nisma të tjera që duan të bëjnë publike. N.q.s. partia juaj është në opozitë, këshilltarët duhet t'i përdorin këto

mbledhje si një mundësi për të theksuar se si administrata aktuale po lë pas dore komunitetin, si dhe për të paraqitur politikën alternative të partisë tuaj. Shtypi lokal zakonisht ndjek mbledhjet e këshillit dhe vëzhgon nga afër. Prandaj, këshilltarët gjithmonë duhet të jenë të vetëdijshëm për sjelljet e tyre dhe sesi duhet t'i interpretojë shtypi këto mbledhje.

Barra e punës së një këshilltari ndryshon në varësi të përgjegjësive që ata marrin brenda këshillit. Të paktën, në Britani, këshilli operon në një mënyrë tipike me një cikël gjashtë javësh - një seri mbledhjesh të komisioneve që pasohet nga i gjithë Këshilli. Një këshilltar pritet të ndjekë mbledhjet e plota të Këshillit dhe të çdo komisioni, në të cilin ata janë caktuar. Veçanërisht, nëse partia ka një shumicë të lehtë ose këshilli është pezull (dmth, asnjë parti politike s'ka kontrollin), atëherë secila nga votat si dhe prania e secilit këshilltar në çdo takim është thelbësore.

Presionet për barrën e punës së çdo këshilltari do të ulen ndjeshëm nëse ata ndërtojnë marrëdhënie të mira me nëpunësin e Komisionit. Këshillat mund të punësojnë qindra punonjës, kështu që këshilltari nuk mund të njohë secilin prej tyre.

Megjithatë, të njohësh ata që punojnë në vende strategjike në departamente të ndryshëm, si dhe

zëvendësit e tyre, do t'i ndihmonte këshilltarët në rastet kur do t'u duhej të gjenin informacion rreth shërbimeve të veçanta, ose kur janë duke marrë vendime mbi prioritetet e shërbimeve. Veçanërisht, kryetarët e komisioneve do të kishin nevojë të ndërtonin marrëdhënie të mira me Nëpunësin e Lartë përkatës, si dhe të takoheshin rregullisht për të diskutuar projektet e veçanta, zhvillimet e politikave ose pikëpamjet e këshilltarëve.

Kur vjen puna për të zgjidhur problemet e zgjedhësve, është e domosdoshme të njohim njerëz të një niveli më të ulët. Të njohësh njerëzit që janë përgjegjës për mirëmbajtjen e dritave të rrugëve p.sh., i kursen këshilltarit kohë dhe shkresurina.

Disa autoritete kanë nëpunës këshilli, detyra e të cilëve është që të ofrojnë mbështetje si sekretarë për këshilltarët në punën e tyre për një çështje. Marrëdhënia midis këshilltarëve dhe nëpunësve është delikate. Nëpunësit duhet të jenë të ndjeshëm politikisht kur japin këshilla, por jo të anshëm politikisht. Këshilltarët duhet të kuptojnë problemet organizative, pa u përfshirë më shumë se ç' duhet në probleme drejtimin/ menaxhimin e hollësishëm të shërbimit. Krijimi i marrëdhënies së duhur është kyç për suksesin e çdo këshilli dhe çdo këshill duhet të ketë një "kod qeverisjeje" që të përshkruajë këtë marrëdhënie.

Roli i komunitetit

Këshilltarët janë zgjedhur për të përfaqësuar qytetarët (fakt që nuk duhet harruar). Votuesit presin që këshilltarët të jenë zëri i tyre në këshill dhe duan që ata të përfshihen në fushata zgjedhore dhe të merren me probleme vendore. Ka katër mënyra, përmes të cilave këshilltarët mund të përdorin rolin e tyre për të zhvilluar lidhje të efektshme me komunitetin:



¹ Mbledhja e Këshillit

Roli i Këshilltarit Vendor

Të mbash lidhje me zgjedhësit

Mbajtja e takimeve këshillimore, ku zgjedhësit mund të ngrenë shqetësimet e tyre; takimet e vazhdueshme me përfaqësuesit vendorë; organizim i pyetësorëve vendorë për të identifikuar shqetësimet; qarkullimi i gazetave me fletë të bashkëngjitura për të kthyer përgjigje; shqyrtimi i ankesave mbi shërbimet e këshillit; t'i kërkohet këshillit që të caktojë pyetësorë dhe anketa opinionesh.

Të mbash lidhje me grupet vendorë

Të ndjekësh mbledhjet e përfaqësuesve të grupeve të komunitetit, p.sh. banorë, qiramarrës, gra, të rinj dhe pensionistë dhe të dëgjosh prioritetet dhe shqetësimet e tyre.

Lehtësimi i Veprimit Vendor

Ngritja e grupeve për përdorimin e shërbimeve; krijimi i komisioneve të lagjeve; organizimi i mbledhjeve të veçanta për të diskutuar çështjet vendore.

Veprimi në Bazë të Informacionit

Ushtrimi i presionit ndaj këshillit për t'iu përgjigjur shqetësimeve të vërteta; përfshirja e këtyre shqetësimeve në platformat e partisë suaj; mbajtja e zgjedhësve të informuar për veprimet e ndërmarra. Kjo punë është e rëndësishme, pavarësisht nëse partia juaj ka ose jo kontrollin e këshillit. Shumë kandidatë e kanë fituar ose ruajtur postin duke punuar për çështjet vendore, kur këshilltari në detyrë nga një parti tjetër ka kaluar shumë kohë në bashki. Gjithashtu, këshilli emëron këshilltarët si anëtarë të grupeve të komunitetit vendor, p.sh. organet qeverisëse të shkollave dhe shoqatat e banorëve. Ky është një rol formal, por që mundëson këshilltarët të mbajnë lidhje me komunitetin. Të përfaqësosh këshillin në këto organe është ndryshe nga përfaqësimi i partisë, e cila gjithashtu mund të bëjë emërimet të tilla.

Roli i Partisë

Gjithashtu, këshilltari është zëdhënës i partisë dhe përgjigjet përpara kryesisë së partisë, si dhe para seksioni të partisë që e përzgjedhi atë si kandidat.

Grupi

Kudo ku Partia juaj arrin me sukses të fitojë më se një vend në këshill, atëherë duhet formuar një kryesi partiakë/klikë. Një grup i efektshëm kryesie është kyç i suksesit në shpërndarjen e objektivave në mbarë këshillin. Ky është vendi ku takohen këshilltarët për të diskutuar politikën, për të zgjidhur mosmarrëveshjet dhe për të mbështetur njëri-tjetrin. Këtu, gjithashtu, ata formojnë strategjinë për të nxitur këshillin që të bëjë ndryshime në komunitetin vendor. Pavarësisht nëse partia juaj është në kontroll të këshillit ose jo, si këshilltar *partiak* që jeni, nga ju pritët që të merrni pjesë në mbledhjet e kryesisë, si dhe të votoni vendimet e marra nga kjo kryesi.

Në shumë vende europiane, rregullorja e partisë i kërkon kryesisë të emërojë një grup bërthamë zyrtarësh/nëpunësish, që kanë si detyrë të sigurojnë se puna e grupit është organizuar efektivisht. Këta janë:

Ø Lideri - i cili, kur partia juaj ka kontrollin, do të jetë edhe lider i këshillit

Ø Zv/lideri

Ø Kryetari

Ø Kryetari i Grupit - i cili është përgjegjës që të sigurojë se anëtarën ndjekin grupin e partisë suaj në komision, si dhe drejtimin e përgjithshëm politik të saj

Ø Sekretari i grupit - administratori politik i Grupit

Numri i zyrtarëve të emëruar do të varet nga madësia e Grupit. Roli i zyrtarëve të një grupi, veçanërisht i kryetarit, është i rëndësishëm për vendosjen dhe mbarëvajtjen e standardeve të pranuar të sjelljes.

E tërë kryesia mbledhet përpara çdo mbledhje të plotë të këshillit dhe grupi i këshilltarëve partiakë në një komision, gjithashtu, mbledhet përpara çdo mbledhje të këtij komisioni. Kjo ndihmon për të bërë të sigurt se të gjithë këshilltarët partiakë kanë mundësi për të diskutuar ndërmjet tyre të gjitha çështjet që i parashtrihen këshillit, si dhe për të marrë vendime kolektive. Megjithatë, këto mbledhje grupi nuk kanë ndonjë status ligjor dhe vendimet e marra në këto komisione janë formale. Mbledhjet e plota të këshillit janë ato që përcaktojnë politikën përfundimtare.

Ka një numër të kufizuar postesh në përgjegjësi të veçantë në Komisionet e Këshillit dhe Kryesinë Partiakë. Jo të gjithë këshilltarët do të jenë në gjendje të mbajnë një nga këto poste. Megjithatë, ata këshilltarë pa përgjegjësi të veçanta, ende kanë një rol brenda kryesisë. Për arsye se ata do të kalojnë më shumë kohë duke punuar me degët e partisë dhe me grupet e komunitetit sesa me anëtarët udhëheqës, ata bëhen një hallkë kryesore informacioni për lidhshmërinë e kryesisë. Ata përftojnë përgjigje mbi atë se si kqyren gjërat nga jashtë bashkisë, si dhe veprojnë si avokatë të kësaj kryesie në komunitet.

Në shumicën e statuteve të partive, shkruhet se Partia pret nga përfaqësuesit e saj që ata të zbatojnë pret nga përfaqësuesit e saj që ata të zbatojnë standardet më të larta të integritetit. Është përgjegjësi e një këshilltari të informojë grupin për interesat e tij, financiare ose jofinanciare qofshin këto dhe t'ia deklarojë ato në kohën e duhur mbledhjes së komisionit, këshillit apo grupit. Karriera juaj si këshilltar nuk do të jetë e gjatë, nëse nuk arrini të siguroni që interesat tuaja vetjake të përfaqësen me interesat tuaja publike.

Për shumë këshilltarë ka njëfarë

tensiononi ndërmjet kryerjes së përgjegjësive përfaqësuese dhe atyre politike. Duke qenë anëtarë të kryesisë, këshilltarët i binden vendimit të grupit, por ndonjëherë kjo bie ndesh me atë se çfarë është më mirë për një zonë zgjedhore të veçantë të këshilltarit apo seksion të komunitetit. Për t'iu siguruar se nuk keni konflikt interesash, mund të merret edhe ndihma e kryetarit të Grupit. Në raste të veçantë (për çështje ndërgjegje dhe aty ku ju vepron me kapacitet gjysëm-juridik, si p.sh. funksioni i licensave, zbatimi i planeve), ju mund të lejoheni të vepron sipas gjykimit tuaj të pavarur.

Puna me degën e partisë

Dega e Partisë të një këshilltari e ka zgjedhur atë të jetë kandidati i saj dhe pret prej tij të merret me çështjet e ngritura nga kjo degë, si dhe të përgjigjet para degës për punën e tij si këshilltar. Anëtarët e degës presin që këshilltari të bëjë:

Ø T'i mbajë ata të informuar mbi politikën dhe zhvillimet e këshillit

Ø Të ngrejë vlerat e partisë në të gjitha veprimtaritë e këshillit

Ø Të përdorin rolin e tyre si fushatues kryesor vendor për të tërhequr anëtarë të rinj dhe të mobilizojë ata ekzistues në veprimtaritë e fushatës

Këshilltarët duhet të ndërtojnë marrëdhënie të mira dyanëshe me zonën zgjedhore (ku këshilltari informon anëtarët e zonës rreth asaj që ndodh në Grup dhe Këshill dhe anëtarët të përftojnë lidhjet me qytetarët dhe ia kalojnë çdo shqetësim këshilltarit). Gjithashtu, anëtarët e zonës veprojnë si skuadër e fushatës politike dhe mund të mbështesin këshilltarin përmes lidhjeve me grupet e komunitetit dhe zgjedhësit. Pra, marrëdhënia e këshilltarit me zonën zgjedhore është vendimtare, si për t'iu mësuar atyre që të kryejnë detyrat efektivisht, ashtu dhe për t'iu rizgjedhur radhës tjetër.

Përgatiti: Ilir Shyta

Draft - Ligji për Vullnetarizmin

1. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i marrëdhënieve që lindin midis vullnetarëve dhe subjektit juridik organizator të vullnetarizmit, për nxitjen dhe zhvillimin e vullnetarizmit në Shqipëri.

Neni 2

Fusha e Zbatimit

a) Ky Ligj, rregullon procesin e vullnetarizmit, ku terminologjia bazë e vullnetarizmit, principet dhe termat rregullohen si të drejta dhe obligime të vullnetarëve dhe të subjekteve organizatore të vullnetarizmit, kushte për formulimin e kontratave të vullnetarizmit dhe kodeve etike, lëshim i certifikatave të vullnetarizmit, vlerësim me çmim për vullnetarizmin dhe garantim i implementimit të këtij Ligji.

b) Ky ligj përfshin/trajton të gjitha llojet e marrëdhënieve midis vullnetarëve dhe të gjithë subjekteve organizatore të vullnetarizmit, gjatë kryerjes së aktiviteteve jofitimprurëse në dobi të një individi tjetër apo të publikut të gjerë.

c) Ky Ligj aplikohet tek shërbimet dhe aktivitetet, realizimi i të cilave organizohet në mënyrat që rregullon ky Ligj.

Neni 3

Përkufizime:

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) **Vullnetar** – është një individ i cili investon kohë, përpjekje, njohuri apo aftësi vetjake me vullnetin e tij të lirë, në shërbim të aktiviteteve dhe veprimtarive të kryera me qëllim mirëqënien e një individi tjetër apo të publikut të gjerë, që zhvillohen sipas mënyrës që parashikon ky ligj, pa kërkuar në shkëmbim asnjë formë shpërblimi financiar apo material për vullnetarizmin e kryer. Një vullnetar është çdo individ që zotëron një aftësi për punë dhe është vullnetar në Shqipëri, apo jashtë vendit në bazë të rregulloreve kombëtare ose ndërkombëtare në fuqi, përveç nëse përcaktohet ndryshe me këtë Ligj.

b) **Vullnetar minoren** është një vullnetar i ri nën moshën 18 vjeç i cili kryen punë vullnetare në Republikën e Shqipërisë.

c) **Vullnetarizëm** – konsiderohet të jetë investim i kohës vetjake, përpjekjeve, aftësive dhe njohurive të dikujt në aktivitete apo shërbime që kanë si qëllim prodhimin e përfitimeve për individë tjetër apo komunitet. Vullnetarizmi duhet të performohet konform këtij Ligji dhe nuk mund të përfshijë asnjë formë pagese apo shpërblimi, përveç rasteve kur ky ligj përcakton ndryshe.

d) **Subjekt Organizator i Vullnetarizmit** - organizata jofitimprurëse, institucioneve publike apo private (në rastet kur përcaktohet me ligj apo me akte nënligjore), që zhvillon aktivitet /veprimtari jofitimprurëse, në dobi të një personi tjetër apo të publiku të gjerë

e) **Kontratë Vullnetarizmi** – Kontratë e lidhur me vullnet të lire, midis subjekteve organizatore të vullnetarizmit dhe vullnetarëve, për zhvillimin e aktiviteteve apo veprimtarive jofitimprurëse në dobi të një individi tjetër apo të publikut të gjerë.

f) **Vullnetarizëm afatgjatë** - është ai vullnetarizëm që zgjat minimalisht 20 orë në javë, për 3 muaj të vazhdueshëm

Neni 4

a) Vullnetarizmi njihet dhe promovohet si një aktivitet i një interesi të veçantë për Republikën e Shqipërisë, për aq sa përmirëson cilësinë e jetës, stimulon pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në jetën shoqërore dhe kontribuon në zhvillimin e një shoqërie më të barabartë, humane dhe më demokratike.

b) Roli i vullnetarizmit dhe rëndësia e tij duhet të përcillen tek të fëmijët dhe të rinjtë nëpërmjet sistemit arsimor të ulët, të mesëm dhe të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Neni 5

(1) Referuar këtij ligji, nuk konsiderohet vullnetarizëm si më poshtë:

- Kryerja e aktiviteteve vullnetare ose ofrimi i shërbimeve që nuk janë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë apo legjislacionin shqiptar dhe konventat ndërkombëtare të miratuara nga Parlamenti Shqiptar

- zhvillimi i aktiviteteve ose ofrimi i shërbimeve kundrejt përfitimit financiar apo material të parregulluar nga kontrata të rregullta sipas Kodit të Punës

- Kryerja e punëve pa shpërblim natyra e së cilave i përket një marrëdhënie punësimi e cila rregullohet nga Kodi i Punës

- Kryerja e punëve ose ofrimi i shërbimeve që njëra palë është e detyruar të kryejë për palë të treta siç përcaktohet me ligj apo akte nënligjore

- Përbushjen e detyrimeve dhe kryerjen e aktiviteteve që një individ është i detyruar ti zhvillojë për një palë të tretë të përcaktuar me ligj apo rregulloret tjera

- Zbatimit të detyrimeve të veçanta në përputhje me vendim gjykate

- Kryerja e veprimtarive ose shërbimeve që janë për përfitim të rrethit

familjar apo miqësor

Parime të veprimtari vullnetar

Neni 6

(1) Aktivitetet vullnetare janë të organizuara nga subjektet organizatore të vullnetarizmit.

(2) Organizatori i vullnetarizmit mund të jetë çdo person juridik i regjistruar në përputhje me Ligjin për OJFtë dhe Institucionet Fetare,

(3) Institucionet Publike të Qeverisjes Qendrore apo Lokale mund të jenë subjekte organizatore të vullnetarizmit në përputhje me këtë ligj dhe sipas përcaktimeve të bazuara në rregullime ligjore dhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë këtë veprimtari.

Neni 7

Përfituesit e Vullnetarizmit janë persona juridik apo fizik, apo publiku i gjerë që përfitojnë shërbimet vullnetare.

2. Principet Themelore të vullnetarizmit

Neni 8

(1) Subjekti Organizator i vullnetarizmit është i detyruar për të trajtuar vullnetarë në bazë të parimit të mundësive të barabarta për të gjithë, pavarësisht moshës, racës, gjuhës, fesë, gjinisë, orientimit seksual, bindjeve politike apo të besimit, përkatësisë nacionale apo sociale, gjendjes financiare, arsimit, pozitës shoqërore, gjendjes civile, përgjegjësive familjare, apo anëtarësimit ose joanëtarësimit në një parti, organizate politike, aftësive fizike ose mendore, sëmundjeve apo karakteristikave të tjera përveç nëse përcaktohet ndryshe nga natyra e një aktiviteti të vullnetarizmit të veçantë dhe të kapaciteteve të vetë vullnetarëve, apo nëse përcaktohet ndryshe me këtë Ligj.

(2) Vullnetarët apo subjektet organizatore të vullnetarizmit janë të detyruar për të trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë përfituesit e një aktiviteti të vullnetarizmit në bazë të parimit të mundësive të barabarta për të gjithë pa dallim:

pavarësisht moshës, racës, gjuhës, fesë, gjinisë, orientimit seksual, bindjeve politike apo të besimit, përkatësisë nacionale apo sociale, gjendjes financiare, arsimit, pozitës shoqërore, gjendjes civile, përgjegjësive familjare, apo anëtarësimit ose jo-anëtarësimit në një parti, organizate politike, aftësive fizike ose mendore, sëmundjeve apo karakteristikave të tjera.

Parimi i Mbrotjes së përfituesve të Vullnetarizmit

Neni 9

(1) Subjektet Organizatore të Vullnetarizmit janë të detyruar të japin vëmendje të veçantë për zgjedhjen dhe trajnimin e vullnetarëve në rastin e grupeve të mëposhtme:

fëmijët, njerëzit me aftësi të kufizuara, personat me probleme të zhvillimit, të moshuar, njerëz të sëmurë apo ato pjesërisht ose plotësisht që u është hequr plotësisht apo pjesërisht zotësia juridike, apo që përgjithësisht konsiderohen si grupe vunerabël. Këto subjekte janë të detyruar gjithashtu ti kushtojnë vëmendje të veçantë aftësive dhe njohurive të nevojshme për realizimin e punës vullnetare me përfitues grupet e përmendura më lart.

(2) Nuk mund të ofrojnë shërbime vullnetare për fëmijët, njerëzit me aftësi të kufizuara, personat me probleme të zhvillimit, të moshuar, njerëz të sëmurë apo ato pjesërisht ose plotësisht që u është hequr plotësisht apo pjesërisht zotësia juridike, apo që përgjithësisht konsiderohen si grupe vunerabël është personat e mëposhtëm:

- Individë që i nënshtrohen trajtimit të detyrueshëm psikiatrik ose programet e trajtimit të varësisë apo ata për të cilët ka një ndalim të ekzekutimit të një veprimtari në lidhje me aktivitetet vullnetare,

- Të dënuar për vepra penale kundër jetës dhe pronës, për krime seksuale, për dhunë ndaj grave apo fëmijëve, për dhunë në familje, për ngacmime seksuale si dhe për individët nën një sanksion për kundërvajtje, siç përcaktohet nga legjislacioni kundër dhunës në familje.

Parimi për ndalimin e shfrytëzimit të vullnetarëve

Neni 10

(1) Kryerjen e punëve ose ofrimi i shërbimeve që njëra palë është e detyruar të kryejë kundrejt shpërblimit apo pagesës për shkak të një kontratë paraprake me palë të treta, me përjashtim të rasteve kur kjo kontratë parashikon realizimin e këtyre punëve / shërbimeve nëpërmjet punës vullnetare

(2) Është e ndaluar për të bërë punë vullnetare që do të përfshijë më shumë se 40 orë në javë në një periudhë që zgjat më shumë se gjashtë muaj pa një pushim prej të paktën gjashtë muaj.

(3) Është e ndaluar për të shfrytëzuar vullnetarët me qëllim për të fituar apo për të rritur fitimin.

Parimi i mbrotjes së vullnetarëve minoren

Neni 11

(1) Një individ minoren duhet të ketë mbushur moshën 16 vjeç para se të

nënshkruaj një kontratë vullnetarizmi dhe mund të ushtrojë punën vullnetare vetëm me miratimin e shkruar të përfaqësuesit ligjor

(2) Vullnetarët minoren mund të kryejnë vetëm ato veprimtari vullnetare të cilat janë të përshtatshme për moshën e tyre, fizike, psikologjike dhe morale nivelin e zhvillimit dhe aftësive që nuk përfaqësojnë ndonjë rrezik për zhvillimin e tyre, shëndetin dhe mbarëvajtjen në shkollë.

(3) Puna e vullnetarëve minoren duhet të kryhet në bazë të mbështetjes dhe mbikqyrjes së subjektit organizator të vullnetarizmit si dhe me miratimin e përfituesve të vullnetarizmit ose përfaqësuesve të tyre ligjore.

(4) Subjekti Organizator i Vullnetarizmit duhet ti kushtoj vëmendje të veçantë mbrojtjes së mirëqënies, shëndetit dhe moralit të vullnetarëve minorenë.

(5) Vullnetarët minorenë nuk duhet të jenë të ekspozuar ndaj:

- Punës vullnetare jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, pa miratimin e një përfaqësuesi ligjor dhe pa shoqërimin e tyre, ose të subjektit organizator të vullnetarizmit

- vullnetarizmit afat-gjatë

- Punë vullnetare të lidhur me stërmundim fizik ose risqe që rrezikojnë apo mund të rrezikojnë jetën e tyre, shëndetin, moralin, zhvillimin ose mbarëvajtjen në shkollë

(6) vullnetarët minorenë zotërojnë të gjitha të drejtat e përcaktuara me këtë Ligj.

Edukimi me qëllim vullnetarizmin

Neni 12

(1) Një individ nën moshën 15 vjeç mund të marrë pjesë në veprimtari vullnetare edukative, si dhe aktivitete që synojnë arritjen e mirëqënies apo edukimin me qëllim vullnetarizmin, por vetëm kur këto aktivitete kontribuojnë në zhvillimin apo socializimin e tij /e saj, duke siguruar se subjekti organizator i vullnetarizmit është një institucion arsimor, ose i mirëqënies sociale ose ndonjë organ tjetër ligjor që kryen aktivitete vullnetare për qëllime edukative, me miratimin nga autoritetet kompetente, institucionet arsimore apo ato për mirëqënien e fëmijës

(2) Në rastin e pikës 1 të këtij neni, subjekti organizator i vullnetarizmit duhet të marrë miratimin me shkrim të përfaqësuesit ligjor.

(3) Personi nga pika 1 e këtij neni nuk duhet të bëni ndonjë punë vullnetare gjatë orarit të zhvillimit të procesit mësimor.

(4) Personi nga pika 1 e këtij neni, mund të ndalojë së bëri çdo punë vullnetare në çdo moment edhe pa pëlqimin e përfaqësuesit ligjor.

Principi i mungesës së shpërblimit për punën vullnetare

Neni 13

(1) Vullnetarët nuk mund të kërkojnë përfitim financiar ose material ose shpërblim ose përmbushje të asnjë detyrimi për punën e tyre vullnetare.

(2) nuk konsiderohen përfitime financiare apo shpërblime, por konsiderohen si kompensime financiare për koston e vullnetarizmit marëdhëniet e mëposhtme:

- marrja e kompensimit financiar për pajisjet, veshje dhe paketë mbrojtjeje të nevojshme për kryerjen e punës vullnetare

- marrjen e kompensimit financiar për udhëtime strehim, dhe ushqim përgjatë aktivitetit të punës vullnetare

- marrjen e kompensimit financiar për shërbime mjekësore për qëllimet e vullnetarizmit

- marrjen e kompensimit financiar për formimin profesional të nevojshme për qëllimet e vullnetarizmit jashtë sistemit arsimor

- marrjen e kompensimit financiar për çdo kosto që shkaktohet nga kryerja e aktiviteteve të vullnetarizmit

- marrjen e kompensimit financiar për sigurimin e jetës ndaj plagosjeve, apo sëmundjeve që shkaktohen nga aktiviteteve të vullnetarizmit, si dhe kompensim financiar për çfarëdo lloj dëmi të shkaktuar nga vullnetari ndaj subjektit organizator të vullnetarizmit ose të një pale të tretë përgjatë ushtrimit të aktivitetit vullnetar

-marrja e një shume financiare nga vullnetari për shpenzime të kryera gjatë udhëtimeve, të cilat nuk mund të tejkalojnë tarifën zyrtare shtetërore për shpenzimet ditore në udhëtime

-Marrja e fondeve financiare për kompensimin e kostove të shkaktuara nga procedura administrative të nevojshme për zhvillimin e punës vullnetare

- Rimbursim shpenzimesh për kostot e tjera që rrjedhin gjatë kryerjes së aktiviteteve vullnetare përtej shpenzimeve të parashikuara, pa tejkaluar parashikimet kontraktuale.

- Marrja e shpërblimit financiar apo material si pjesë e çmimeve inkurajuese për vullnetarizmin

Parimi i Vullnetarizimit dhe Solidaritetit të Punës Vullnetare

Neni 14

Aktivitetet e kryera ose shërbimet e ofruara të cilat nuk janë rezultat i vullnetit të lirë një vullnetari e nuk konsiderohen vullnetarizëm.

Parimi i Ndërkombëtarizimit të Vullnetarizmit

Neni 15

(1) Shtetasit shqiptarë vullnetarë jashtë vendit kanë të gjitha të drejtat

dhe detyrimet që kanë të bëjnë me këtë ligj dhe detyrimet ligjore ndërkombëtare përkatëse.

(2) Subjekti organizator i vullnetarizmit ka për detyrë të finalizojë një marëveshje në përputhje me këtë ligj lidhur me qytetarët shqiptarë që ka angazhuar të kryejnë punë vullnetare përtej territorit të Republikës së Shqipërisë.

(3) Shtetasit e huaj që mund të bëjnë punë vullnetare në Shqipëri, janë subjekt i këtij ligji dhe akteve të tjera rregulluese kombëtare dhe ndërkombëtare të miratuara nga Shteti Shqiptar.

(4) Kontrata e vullnetarizmit e nënshkruar nganjë vullnetar i huaj në formë të shkruar dhe në përputhje me këtë ligj konsiderohet si provë e nevojshme për lejen e përkohshme të qëndrimit në Shqipëri

3. Autoriteti kompetent për zbatimin të këtij ligji dhe organ këshillimor

Neni 16

(1) Organi kompetent për zbatimin e këtij ligji është organi qendror shtetëror është Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile - AMSHC.

(2) AMSHC është përgjegjëse për:

- Sigurimin e zbatimit të këtij ligji dhe rregullave të tjera që dalin nga ajo

- monitorimi dhe vlerësimi i gjëndjes së situatës së vullnetarizmit dhe propozimi i masave që duhen ndërmarë

- Mbledhjen e informacionit për numrin e subjekteve organizatore të vullnetarizmit, vullnetarëve në Republikën e Shqipërisë dhe të qytetarëve shqiptarë vullnetare jashtë vendit, si dhe informacione të bazuara në raportet vjetore të subjekteve organizatore të vullnetarizmit

- Ngritjen e Komitetit Kombëtar për Zhvillimin e Vullnetarizmit - KKZHV

- Ndërmarrjen e masave të tjera dhe veprimeve të nevojshme me qëllim zhvillimin e vullnetarizmit dhe zbatimin e këtij ligji

Neni 17

Komiteti Kombëtar për Zhvillimin e Vullnetarizmit - KKZHV (më tej: KKZHV) është një organ këshillimor i qeverisë shqiptare puna e të cilit është publike dhe që zbaton masat dhe aktivitetet me qëllim promovimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të vullnetarizmit, me një theks të veçantë në:

- Propozon masa për promovimin e pozitës sociale të vullnetarëve

- Bashkëpunon me autoritetet kompetente në mënyrë që të propozojë rregullime ligjore më të përshtatshme në të mirë të zhvillimit të vullnetarizmit

- Vendos për dhënien e Çmimit Kombëtar të Vullnetarit të Vitit

- Propozon pranë organeve kompetente të ekzekutivit projektndryshimet e nevojshme të legjislativitetit mbi vullnetarizmin

- Hartimin e Kodit Etik të Vullnetarëve

- Kryerjen e veprimtarive të tjera me qëllim të zhvillimit të mëtejshëm të vullnetarizmit

- Zbatimin e masave të tjera dhe aktiviteteve të përcaktuara me këtë Ligj

Neni 18

Në përmbushjen e objektivave të veta, KKZHV në mënyrë indirekte bashkëpunon me:

AMSHC

Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta, Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, dhe të organeve të tjera qeveritare, organet qendrore të shërbimeve sociale, njësitë e qeverisjes lokale dhe organizatat e shoqërisë civile.

Neni 19

(1) KKZHV përbëhet nga 19 anëtarë nga të cilët 9 janë nga institucionet publike dhe 10 nga shoqëria civile. Vendimi për rregullat dhe procedurat e emërimit të anëtarëve dhe funksionimit të KKZHV rregullohet me akte nënligjore dhe është kompetencë e Këshillit të Ministrave.

Neni 20

(1) Anëtarët e KKZHV emërohen për dy vjet dhe mund të emërohen përsëri.

(2) KKZHV vendos për Rregulloren e Punës dhe Planit të Veprimit në mandatin e tyre.

(4) Anëtarët e KKZHV zgjedhin kryetarin dhe zv.kryetarin nga nivelet e tyre në bazë të shumicës së votave.

(5) Anëtarët e KKZHV nuk marrin kompensim për punën e tyre, por kanë të drejtë për një kompensim të shpenzimeve që dalin nga puna e Komitetit.

4. KODI ETIK I VULLNETARIZMIT

Neni 21

(1) KKZHV vendos për procedurën e hartimit të Kodit Etik të Vullnetarizmit në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe e miraton atë me shumicë votash.

(2) Procedura për hartimin e Kodit është publike.

(3) Aspekti publik i hartimit të Kodit sigurohet nëpërmjet përfshirjes së të gjitha palëve të interesuara në një debat publik në kuadër të periudhës në të cilën Kodi hartohet.

(4) Kodi përcakton zhvillimin e vullnetarizmit, statusin e vullnetarëve, rregullat e funksionimit të subjekteve organizatore të vullnetarizmit dhe përfituesve të punës vullnetare, në përputhje me parimet e vullnetarizmit nga ky ligj.

(5) Kodi botohet në Fletoren Zyrtare.

(6) Çdo subjekt organizator i vullnetarizmit mund të përcaktojë parimet e veta etike që dalin nga specifikat e mundësive të tij dhe nuk janë në kundërshtim me Kodin, parimet bazë të vullnetarizmit të përcaktuara në këtë Ligj ose rregullat e brendshme dhe ndërkombëtare që zbatohen për zhvillimin e vullnetarizmit.

5. Çmimi Kombëtar i Vullnetarit të Vitit

Neni 22

(1) Çmimi Kombëtar i Vullnetarit të Vitit (më tej Çmimi) është njohja e madhe për punën vullnetare në Republikës e Shqipërisë si një kontribut në promovimin e vullnetarizmit dhe aktivitetet e tjera vullnetare.

(2) Shpërblimi jepet për vullnetarin dhe Subjektin Organizator të Vullnetarizmit si një çmim vjetor.

(3) KKZHV vendos për dhënien e çmimit nga pika 1 e këtij neni.

(4) Fondet e nevojshme për dhënien e çmimit dhe kostot e tjera materiale që lidhen me të janë të siguruar çdo vit nga buxheti i AMSHC.

(5) AMSHC, fushëveprimi i të ciliës përfshin aktivitete të lidhura me zhvillimin e shoqërisë civile dhe të vullnetarizmit, përcakton kriteret dhe procedurat për dhënien e çmimit mbi bazën e Rregullores për Çmimin Kombëtar të Vullnetarit të Vitit, vendos për vlerën e tij financiare, hartimin e medalje dhe pllakë dhe çështje tjera të rëndësishme që lidhen me dhënien e çmimit.

6. Kontrata e Vullnetarit

Neni 23

(1) Duke nënshkruar kontratën e vullnetarit, subjektet organizatore të vullnetarizmit dhe vullnetarët përcaktojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e ndërsjella dhe aspekte të veçanta të aktivitetit individual të vullnetarizmit ose të shërbimit përkatës.

(2) Kontrata e vullnetarizmit behet e detyrueshme në rastet e mëposhtme:

- Vullnetarizëm me rrezik të lartë për dëmtimin e shëndetit dhe jetës së vullnetarit

- Vullnetarizmi i shtetasve të huaj në Shqipëri

- Vullnetarizëm i shtetasve shqiptarë jashtë territorit të vendit, atëherë kur aktiviteti vullnetar organizohet nga dy entitete, një prej të cilave e ka qendrën në Shqipëri.

- Vullnetarizëm afatgjatë

- Vullnetarizëm për fëmijë, persona me aftësi të kufizuara, persona me probleme zhvillimi, të moshuar, të sëmurë, persona pjesë e grupeve të marginalizuara, ose ato me

7. Të drejtat dhe detyrimet e vullnetarëve dhe subjektet organizatore të vullnetarizmit

Neni 24

(1) Një vullnetar ka të drejtë të:

-Një vërtetim me shkrim për angazhimin e tij vullnetar

-Një kontratë me shkrim për kontributin e tij vullnetar nëse ai e dëshiron

-Vetëdije e ekzistencës të Kodit dhe normat etike të rëndësishme për aspekte të veçanta të vullnetarizmit

-Trajnime adekuate me qëllim të përmirësimit të cilësisë së aktiviteteve që do të kryhen dhe shërbimet e dhëna, sidomos nëse kjo kërkohet nga natyra e aktiviteteve të vullnetarizmit dhe shërbimet e ofruara

-Ndihmë profesionale dhe përkrahje gjatë vullnetarizmit

-Kompensimin e shpenzimeve të kontraktuara që rrjedhin nga vullnetarizmit

-Kushte të përshtatshme të sigurisë në punë në pajtim me natyrën e aktiviteteve të vullnetarizmit

-Pajisjet mbrojtëse, në përputhje me natyrën e aktiviteteve të vullnetarizmit dhe shërbimet e ofruara që do të kryhen

-Vetëdijen për rreziqet që rrjedhin nga natyra specifike e vullnetarizmit

-Pauzë të përditshme të paracaktuara

-Mbrojtjen e të dhënave personale

-Pjesëmarrja në vendim-marrje në lidhje me vullnetarizmit në përputhje me mundësitë e subjektit organizator të vullnetarizmit dhe aspekte të veçanta të vullnetarizmit

(2) mungesat e justifikuar nga subjekti organizator i vullnetarizmit nuk mund të jetë arsye për humbjen e të drejtave të vullnetarit

(3) Të drejtat e veçanta të vullnetarëve, të përcaktuara me këtë ligj nuk kanë pse të përfshihen në kontratën e vullnetarizmit

Neni 25

(1) Vullnetarët janë të detyruar të:

- Të kryejnë aktivitetet e vullnetarizmit në përputhje me rregulloret dhe rregullat e etikës profesionale, si dhe me udhëzimet e dhëna nga subjekti organizator i vullnetarizmit

-Të mbajnë një sekret profesional, si dhe të dhëna konfidenciale dhe personale për subjektin organizator të vullnetarizmit apo përfituesit e punës vullnetare

(2) Vullnetarët janë të detyruar të ndjekin udhëzimet e subjektit organizator

të vullnetarizmit-së, përveç rasteve kur udhëzimet:

-paraqesin një rrezik për jetën dhe shëndetin e vullnetarit, si dhe atë të njerëzve të tjerë

-konsiderohen moralisht të papranueshme nga ana e vullnetarit

-konsiderohen në kundërshtim me kontratën e vullnetarizmit

(3) Nëse këto udhëzime mund të shkaktojnë dëme në vullnetare, përfituesit e punës vullnetare apo palëve të treta, vullnetarët janë të detyruar për të paralajmëruar subjektet organizatore të vullnetarizmit në lidhje me këtë

(4) Vullnetarët nuk kanë asnjë përgjegjësi për çdo dëm të shkaktuar në qoftë se ata kishin paralajmëruar më parë subjektet organizatore të vullnetarizmit për rrezikun e mundshëm.

Neni 26

(1) Subjekti Organizator i Vullnetarizmit janë të detyruar:

-Të respektojë të drejtat e vullnetarit

-Të marrin të gjitha përgjegjësitë e tij ndaj vullnetarëve

-Të sigurojë plotësimin e kushteve të nevojshme për respektimin e të drejtave të vullnetarëve

-Të lëshojë një vërtetim me shkrim për punën vullnetare dhe të përfshijë informacion të nevojshëm në përshtatje me kërkesat e këtij ligji

-Të ofrojë bazën e nevojshme materiale të sigurtë dhe fonde për kryerjen e aktiviteteve të vullnetarizmit

-Të sigurojë rimbursimin e kostove që dalin nga puna vullnetare

-Të sigurojë mbrojtjen e të dhënave personale të vullnetarëve dhe mbrojtjen e të dhënave të tjera private me kërkesë të vullnetarit

-Të sigurojë realizimin e kushteve të nevojshme për të respektuar të drejtat e përshkruara me këtë ligj

(2) Subjekti Organizator i Vullnetarizmit është i detyruar që të realizojë sigurimin shëndetësor dhe shoqëror të vullnetarëve për rastet e sëmundjeve profesionale dhe pasojat e aksidenteve në qoftë se

-vullnetarizmi është kryer në kushte të përfaqësojnë një rrezik për jetën dhe shëndetin e vullnetare

- palët kanë rënë dakord kështu në kontratë.

Neni 27

(1) Subjekti Organizator i vullnetarizmit është i detyruar të raportojnë pranë AMSHC për aktivitetet e kryera ose të shërbimeve të dhëna, siç përcaktohet në këtë ligj.

(2) Përmbytja e raportit nga pika 1 e këtij neni, afatet për paraqitjen e raportit dhe informatat të tjera të rëndësishme

për raportin do të jetë e përshkruar në Kodin e Etikës së Vullnetarizmit.

Neni 28

(1) Çertifikata e vullnetarizmit përmban: të dhënat personale të vullnetarit, informacion për periudhën e vullnetarizmit, trajnimit nëse ka pasur, përshkrim të shkurtër të aktiviteteve të vullnetarizmit dhe specifikat tjera të vullnetarizmit.

(2) Me përjashtim të të dhënave nga pika 1 e këtij neni, certifikata e vullnetarizmit gjithashtu përmban nënshkrimin vullnetarit, nënshkrimin e një personi që vepron si përfaqësues i subjektit organizator të vullnetarizmit, vulën e organizatorit, i cili garanton saktësinë e të dhënave të deklaruara.

(3) Subjekti Organizator i Vullnetarizmit mund të lëshojë karta dhe dokumente të tjera me qëllim dhënien e dëshmimeve të statusit të një vullnetari dhe kjo mund të konsiderohet si një certifikatë e vullnetarizmit në qoftë se ato përmbajnë të dhëna dhe elemente nga pika 1 dhe 2 të këtij neni.

(4) shtetasit shqiptarë që janë të angazhuar si vullnetare jashtë vendit në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit të organizuara nga subjekte organizatore të vullnetarizmit me seli në Shqipëri kanë të drejtë për një certifikatë vullnetarizmi prej tyre.

8. MBIKËQYRJA

Neni 29

(1) Mbikëqyrja administrative e zbatimit të këtij ligji dhe të rregulloreve që dalin nga ajo është ekzekutuar nga AMSHC.

(2) Mbikëqyrja inspektuese e zbatimit të këtij ligji dhe të rregulloreve që dalin nga ajo, si dhe akte të veçanta, kushteve të subjekteve të mbikëqyruar juridik dhe fizik kryhet nga zyrat inspektuese të qeverisë qendrore të shtetit, në varësi të fushës së tyre dhe në përputhje me rregulloret e veçanta.

10. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 30

Aspektet e nuk vullnetarizmit të rregulluara me këtë ligji, si dhe marrëdhëniet që lindin nga kontrata e vullnetarizmit që nuk janë të përcaktuara me këtë Ligj janë objekt i dispozitave të përgjithshme ligjore.

Neni 31

Këtij ligji hyn në fuqi ditën e botimit në Gazetën Zyrtare